

VENDIM
Nr.373, datë 27.3.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË MEMALIAJ TË QARKUT TË GJIROKASTRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Memaliaj të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Memaliaj të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.471, datë 16.7.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë Memaliaj të qarkut të Gjirokastrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Memaliaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia: Memaliaj

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-7	Prona që përdoren për realizimin e programeve mësimore	Në pronësi
8-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin pulik	Në pronësi
11-13	Monumente historike, buste me interes vendor&prona social-kulturore e sportive	Në pronësi
14,15,16	Shërbimi funeral	Në pronësi
17,19,47,68-114,116-124,169,204-241	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi
18,20-45,48-67,115,125	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
126,127-141	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile dhe strehimit	Në pronësi
147	Prona që përdoren në fushën administrative	Në pronësi
175-179,181-183, 185-198	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, tokë bujqësore	Në përdorim
46,180,184	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë, tokë jobujqësore	Në pronësi

149-168	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
199,200	Sistemi i kanalizimeve të ujërave të zeza	Në pronësi